

Draft
Korniza mbi Standardet e Praktikës Profesionale
për Mësimdhënësit e Kosovës

1. Hyrje

Ky dokument mund të shërbejë si udhëzues për aktivitetet që përfshijnë përgatitjen e mësimdhënësve, mësimdhënjes, dhe ngritjes profesionale të mësimdhënësve dhe vlerësimit të tyre. Korniza është dezajnuar si mjet për të definuar **kualitetin e mësimdhënjes** dhe llojet e **njohurive, shkathtësive dhe pikëpamjeve** që kanë të bëjnë me kompetencat kyçe (themelore) për përgatitjen e programeve për mësimdhënësit të cilët do të diplomojnë, dhe poashtu do të shërbejë dhe si studim bazë për aftësimin profesional të mësimdhënësve fillestar.

Korniza mund të ngrisë vetëdijën e publikut rreth kërkesave dhe përgjegjësive të cilat mësimdhënësit duhet t'i përmbushin dhe t'iu ndihmojmë në ngritjen e tretmanit të punës së mësimdhënësve në shoqëri.

Korniza mbi Standardët e Praktikës Profesionale fokusohet :Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë do të bëjë akreditimin e programeve për përgatitjen e mësimdhënësve dhe certifikimin e tyre.

- Fakultetet e Edukimit të përgatisin, ndryshojnë dhe të shpërdajnë programet për përgatitjen e mësimdhënësve.
- Të përgatiten studentet për tu bërë mësimdhënës.
- Që mësimdhënësit të cilët kërkojnë ndihmë të iu ofrohet ndihma për aftësimin e mëtutjeshëm profesional.
- Mbikëqyrësit, administratorët, vlerësuesit dhe mentorët të cilët kanë nevojë për kriterët e përgjithshme për të definuar kërkesat dhe performancën

2. Standardet e Praktikës Profesionale

Çfarë aftësish duhet të ketë mësimdhënësi Kosovar?

Çfarë pikëpamjesh morale dhe profesionale duhet të kenë mësimdhënësit e shekullit 21 drejtë të nxëniet dhe nxënësit?

Si definohet 'mësimdhënia kualitative'?

Kriteret e dhëna në vijim paraqesin një pasqyrë të mësimdhënies, shkathtësive kualitative, njohurive dhe pikëpamjeve që i nevojiten një mësimdhënësi.

Mësimdhënësi duhet të jetë një person i **përgatitur në aspektin akademik dhe profesional**¹ :

1. Të jetë i vetëdijshëm se kontestet e ndryshme ndikojnë në mësimdhënie dhe nxënie.
2. Të përcjellë dhe implementojë kurikulën zyrtare.
3. Të njeh mirë lëndën e vet.
4. Të krijojë një repertoar të gjerë të shkathtësive profesionale dhe një stil personal.
5. Të planifikojë dhe përgatisë mirë orën e mësimin.
6. Të menaxhojë klasën mirë.
7. Të krijojë një ambient pozitiv të nxënjes (të të mësuarit) në klasë.
8. Të njeh dhe aplikojë parimet e çmuarjës dhe vlerësimit të nxënësve.
9. Ta konsideroi vetën si një aktor të ndryshimeve
10. Të përkrah parimet demokratike dhe të drejtat e njeriut.
11. Të besojë se aftësimi përmanent ngrit aftësitë (shkathtësitë) personale.
12. T'i njeh dhe t'i kuptojë bazat ligjore dhe morale të profesionit të vet.

¹ "Akademik" – nënkupton njohjen e lëndës të cilën ai/ajo studjon, "profesional" nënkupton aspektin e njohurive pedagogjike, didaktike, psikologjia e mësimdhënjes, arti i mësimdhënjes.

3. Sqarime: Përshkrimi i njohurisë, shkathtësive, dhe pikëpamjeve që kërkohen për të përmbush Standardët e Praktikës Profesionale

Të dymbëdhjetë kërkesat e dhëna më lartë janë si rezultat i një diskutimi të gjerë. Ato do të kenë vlerë vetëm nëse përshkohen me shembuj konkret dhe aplikohen në fusha konkrete.

Ne jemi munduar të spjegojmë secilin nga standardet më gjerësisht. Më këtë rast, jemi munduar që të mos përdorim zhargone profesionale në mënyrë që mendimet e prezentuara të jenë sa më të qarta, të kuptueshme dhe transparente.

Sqarimet (spjegimet) poashtu mund të ndihmojnë të qartësojnë se të gjitha standardet janë të ndërlidhura; përseritjet në paragrafe janë berë me qellim.

1. Të jetë i vetëdijshëm se kontestet e ndryshme ndikojnë në mësimdhënie dhe nxënie

- Të jetë i vetëdijshëm për strukturën e ndryshme të nxënësve dhe efektet e tyre: si mosha; gjinia; gjendja familjare; pjekuria; aftësitë dhe problemet e nxënësve; njohuritë paraprake; gjendja sociale; marrëdhënjet në mes të nxënësve; prejdardhja etnike, kulturore dhe gjuhësore; gjendja dhe kushtet mentale.
- Të ketë parasysh ndryshueshmërinë e shkollës; gjendjen e shkollës, numrin e stafit, madhësinë dhe konstrukcionin e klasës, mbështetjen nga kolegët dhe administrata, dhomat dhe objektet ndihmëse.
- Të ketë parasysh ndryshueshmëritë e veta dhe efektet: përvojën në mësimdhënie, gjendjen e vet fizike dhe psikike.
- Të jetë i informuar rreth ligjeve dhe rregulloreve; rreth kornizës së kurikulës
- Të jetë i vetëdijshëm rreth ndryshueshmërisë sa iu përketë prindërve dhe komunitetit si dhe efekteve të tyre: involvimi i prindërve dhe ndihma e tyre për nxënjen e fëmijëve, mjedisi i tyre shoqëroro-ekonomik, multikulturalizmi, kooperimi i tyre me shkollën dhe me institucionet tjera, ndikimet regjionale dhe ato jashtë regjionale.

2. Të përcjell kurrikulën zyrtare

- Të njeh kurrikulën dhe lëndën e vet dhe të jetë i vetëdijshëm rreth ndërlidhjes së me lëndet tjera si dhe rreth çështjeve ndërkurikulare siç janë vlerat demokratike, shkathtësitë edukative nga jeta, dhe edikimi rreth ambientin;
- Që planet e veta vjetore / mujore / javore dhe ditore t'i bazojë në kurikul;
- Të shfrytëzojë njohuritë e veta akademike dhe profesionale për të identifikuar përfshirjen e koncepteve kyçe (thelbësore) në fushën kurikulare dhe të jetë i sigurtë se ato që janë esenciale janë përfshirë në mësimdhëniën e tij / saj;
- Të aplikojë njohuritë e veta akademike dhe profesionale që të ndërtojë njësinë mësimore sipas nevojës dhe aftësive të nxënësve;
- Të vendos rreth renditjes së temave dhe se sa do të zgjerohet apo do të thellohet në fushën lëndore të cilën e punon duke u bazuar në nevojat dhe aftësitë e nxënësve.

3. Ta njeh lëndën (lëndet) e vet mirë

- Të ketë njohuri akademike të mjaftueshme rreth lëndës (lëndëve) së vet.
- Të dijë se ku të gjej dhe si të kërkojë njohuri më të hollësishme rreth lëndës së vet, nëse është nevoja.
- Të jetë i informuar rreth zhvillimeve dhe ndryshimeve të lëndës së vet.
- Të dijë se si të reduktojë konceptet më komplekse sipas nivelit që kërkon grupi i nxënësve (klasa).
- Të njeh ndërlidhjen e lëndës së vet me lëndët tjera dhe ndërlidhjen e jetës së përditshme në aplikimin e lëndës.

- Të njeh mënyrat e thjeshta (të zakonshme) të interpretimit të lëndës dhe se si ajo të mësohet nga nxënësit (p.sh. të shfrytëzojë eksperimente në lëndët natyrore-shkencore, të ndërlidhë përvojat nga jeta e përditshme).

4. Të krijon një repertoar të gjerë të shkathëtesive profesionale dhe një stil personal

- Të pranojë se ka një numër metodash të mësimdhëniës dhe nxëniës si dhe një numër metodash të ndërtimit të orës mësimore.
- Të njeh dhe shfrytëzojë një sërë (repertuar të gjerë) metodash dhe teknikash të planifikimit të mësimdhëniës, menaxhimit të klasës dhe vlerësimit.
- Të shfrytëzojë aftësitë e vrojtimit, analizimit dhe interpretimit për të adaptuar planin dhe mësimdhëniën sipas nevojave të grupit të nxënësve (klasës) dhe sipas situatës.
- Të shfrytëzojë me mjeshtri teknikat komunikuese në mënyrë që të zgjerojë të kuptuarit e dyanshëm, zgjedhjen e konflikteve dhe marrjen e vendimeve në mënyrë demokratike.
- Të krahasojë stilet e mësimdhëniës duke vizituar kolegë të ndryshëm dhe të reflektojë stilët e tyre. T'i kombinojë ato me përvojën e vet profesionale në mënyrë që të përmirësojë mësimdhëniën.
- Të jetë i vetëdijshëm se të folurit dhe lëvizja mund të krijojnë atmosferë pozitive dhe negative në klasë, dhe të dij se si t'i shfrytëzojë ato (p.sh. britma, të mrrolurit, përplasja e derës). Të shfrytëzojë aftësitë joverbale për të përmirësuar mjedisin e të mësuarit.
- Mësimdhëniën ta mbështesë në parimet demokratike dhe të drejtave të njeriut.
- Të ketë mirëkuptim dhe njohuri se si të iu qaset nxënësve me nevoja të posaçme.

5. Të planifikojë punën e tij / saj profesionale me kujdes

- Ta njoh mirë kurikulën e lëndës së vet, relacionet me lëndët tjera dhe çështjet ndërkurikulare.
- Të jetë në gjendje të definojë qartë objektivat (ato akademike dhe profesionale) të cilat dëshiron që nxënësit t'i arrijnë dhe të iniciojë aktivitete me qëllim të nxënjes më të mirë sipas objektivave.
- Plani të jetë i bazuar në njohuritë e veta si dhe në njohuritë paraprake të nxënësve.
- Të monitorojë nxënësit përherë në mënyrë që të përcjell nevojat, përparësitë, dobësitë, intereset dhe përparimin individual të nxënësve.
- Të ketë njohuri të mjaftueshme rreth metodave të ndryshme të mësimdhëniës dhe mënyrave të ndërtimit të orës mësimore.
- Të dij se si të aplikojë njohurin e vet në klasë në mënyrën më të përshtatshme për të përmbushur nevojat dhe aftësitë e nxënësve si dhe standardët e kërkuara sipas kurikulës.

6. Të menaxhon klasën mirë

- Të menaxhojë sjelljet në klasë për të përforcuar të nxënit.
- T'i trajtojë nxënësit në pajtim me ligjet relevante.
- Të jetë i vetëdijshëm për modelet e ndryshme të rolit të mësimdhëniës dhe të reflektojë në mënyrë kritike në këto modele.
- Të njoh nevojat dhe aftësitë e grupit specifik (klasës) të nxënësve me të cilët ai / ajo punon.
- Të reflektojë në mënyrë kritike në pikëpamjet e veta ndaj nxënësve dhe monitorimit të mësimdhëniës së vet.
- Të njoh modele dhe strategji të ndryshme të sjelljeve në grupe si the t'i ndërtojë dhe t'i përmirësojë ato.
- Ta njoh psikologjinë e fëmijëve dhe teorinë e të mësuarit.

- Të jetë në gjendje të ndryshojë planin e orës mësimore duke u mbështetur në vet obzervimin e vazhdueshëm të nxënësve për të përmbushur objektivat e orës mësimore në një mënyrë tjetër.
- Të ofrojë aktivitete të ndryshme të të nxënësve për t'i përmbushur nevojat e të gjithë nxënësve duke përfshirë edhe nxënësit më nevojat të posaçme.

7. Të krijojë një ambient pozitiv të nxënësve në klasë

- Të shfrytëzojë metoda të ndryshme për të angazhuar nxënësit në mësimdhënje dhe bashkëpunim.
- Të krijojë një ambient stimulues në klasë duke ekspozuar punimet e nxënësve, modele, fotografi, etj.
- Të përkrah nxënësit për vetëvlerësim dhe të iu shmangët hutimit (ngatërrimit) dhe të friguarit e nxënësve.
- Të punojë në ndërtimin e marrdhënjeve të besimit dhe kooperimit me student. ???
- Të pranojë idetë dhe kritikën nga nxënësit.
- Të përfshijë nxënësit në procesin e marrjës së vendimeve dhe të jetë konsekuent në sjelljet dhe kërkesat e tij / saj.
- Të jetë transparent ndaj nxënësve rreth kërkesave (nevojave) për të mësuar dhe kriterëve të vlerësimit .
- Të ketë parasysh rrethanat (kontekstet) personale të nxënësve dhe situatën e të mësuarit, ti ndihmojë nxënësit në zgjedhjen e problemeve të tyre personale brenda kufijve të aftësive të veta profesionale.

8. Të njoh dhe aplikojë parimet e çmuarjes dhe vlerësimit të nxënësve

- T'i kuptojë parimet e vlerësimit dhe monitorimit si dhe llojet e ndryshme të vlerësimit të cilat mund të shfrytëzohen.
- Të jetë në gjendje të bëjë monitorimin, vlerësimin, të mbaj shënime dhe të raportojë mbi aftësitë, nevojat dhe përparimin e nxënësve në mënyrë individuale.
- Të jetë në gjendje që rezultatet e vlerësimit t'i shfrytëzojë për të vlerësuar dhe përmirësuar mësimdhënjen si dhe për të përmirësuar standardet në përmbushjen e rezultateve.
- Të ketë njohuri të mjaftueshme rreth teknikave të ndryshme të monitorimit dhe vlerësimit për të parë nëse është mësuar materia dhe se sa është mësuar
- Që kërkesat për të mësuar dhe kriteret e vlerësimit t'i bëjë transparente për nxënësit.
- Që vlerësimi të mos bëhet vetëm nëpërmes testeve gojore dhe me shkrim por vlerësimi të bëhet edhe nëpërmes mes monitorimit të punës në grupe, vlerësimi i projekteve të ndryshme, puna në ekipe; të vlerësohet aktiviteti i gjithmbarshëm i nxënësve.
- Të vlerësojë jo vetëm rezultatin e punës por edhe procesin e saj.
Rezultatet e vlerësimit të nxënësve t'i komunikohen prindërve rregullisht.

9. Ta shoh veten si një aktor të ndryshimeve

- Në nivel klase: të iniciojë inovacione dhe t'i përkrah ndryshimet bazuar në gjykimin (mendimin) dhe njohuritë e veta profesionale.
- Të përkushtojë (shoh vetën) përgjegjësinë e vet për zhvillimin dhe mirëqenjen e nxënësve të vet.
- Në nivel shkolle: të përfshijë kolegët, nxënësit, prindërit dhe komunitetin në diskutimin e çështjeve dhe në aktivitetet të cilat kanë për qëllim përmirësimin e jetës dhe ambientit në shkollë.

- Në nivel të përgjithshëm: Të mbështesë përmirësimin e arsimit dhe mësimdhënjes në nivel lokal, regjional, kombëtar dhe ndërkombëtar.
- Të mbështesë rrjetin e zhvillimit të mësimdhënësve në të gjitha nivelet.
- Të përcjell zhvillimet regjionale, ndërkombëtare dhe diskutimet rreth çështjeve të arsimit, mësimdhënies dhe të mësuarit.

10. Të përkrah parimet Demokratike dhe Drejtat Njerëzore

- Të përkrah dhe të veprojë mbi parimet e tolerancës dhe barazisë në klasë, në shkollë si dhe në ambientin rreth shkollës.
- Të sigurojë të drejta dhe mundësi të barabarta për të gjithë nxënësit pa marrë parasysh gjinin e tyre, përkatësinë etnike dhe religjioze.
- Të sigurojë se nxënësit me nevoja të posaçme kanë të njejtat të drejta për arsimim si të gjithë të tjerët. Kjo ka të bëjë edhe me nxënësit që kanë vështirësi në të mësuar por edhe nxënësit me të meta që kanë talent dhe aftësi të posaçme.

11. Të besojë se aftësimi përmanent ngrit aftësitë (shkathtësitë) personale.

- Të besojë në konceptin e të mësuarit të përhershëm. Askush nuk është asnjëherë i përsosur por gjithmonë çdonjëri mund të duhet të përmirësohet vazhdimisht.
- Të mendojë në mënyrë kritike rreth mësimdhënies së vet dhe sjelljeve shoqërore të veta, të monitorojë dhe të kërkojë që gjithnjë ta përmirësojë mësimdhënien e vet duke u bazuar në Standardët e Praktikës Profesionale.
- T'i ngrisë vazhdimisht njohuritë e veta akademike dhe profesionale; p.sh. duke marrë pjesë në seminare, duke lexuar literaturë përkatëse apo duke përcjellur konferenca të ndryshme.
- Të mundohet të implementojë teknologjinë e re me të cilën disponon shkolla dhe të jetë i informuar rreth zhvillimeve teknologjike dhe të mjeteve mësimore.
- Të konsultohet dhe të këmbëjë përvoja me kolegët, të marrë pjesë në aktivitete të ndryshme që kanë karakter të zhvillimit profesional, në nivel shkolle dhe në nivel regjional.
- Të kujdeset për zhvillimin profesional dhe personal të nxënësve dhe kolegëve, të iu jap dhe të pranojë këshilla dhe rezultate kthyes (feedback).

12. Ta njoh dhe ta kuptojë bazën ligjore dhe morale të profesionit të vet

- T'i njoh dhe t'i kuptojë ligjet dhe rregullorët përkatëse të profesionit të vet.
- Të përcjell ndryshimet në ligjet dhe rregullorët e shkollës.
- Të njoh dhe të përcjell Kodin Etik formal dhe joformal të profesionit të vet.
- T'i dij përgjegjësit dhe detyrat e veta si mësimdhënës i cili gjithnjë do të merret si model për nxënësit dhe komunitetin.
- Të përcjell dhe përkrah rregullat e shkollës dhe të angazhohet në përmirësimin e tyre po që se është nevoja.

Korniza e Re e Kurikut të Kosovës

Korniza e kurrikulit dhe filozofia e saj rreth mësimdhënjes dhe të mësuarit parasheh një numër kërkesash që një mësimdhënës duhet t'i përmbush në bazë të standardeve dhe objektivave që paraqet ajo. Elementët kyçe janë paraqitur në vijim. Ato korrespondojnë ngushtë me parashikimet e këtijë drafti për mësimdhënësin e ardhëshëm të Kosovës të paraqitura më lartë.

Sipas Kornizës së Re të Kurrikulit të Kosovës¹, , mësimdhënësit duhet :

- T'a kuptojnë lëndën të cilën e japin.
- Të veprojnë si moderatorë të nxënjes.
- Të balancojnë metodat e reja dhe ato tradicionale në mësimdhënje dhe vlerësim.
- Të aplikojnë çasje konstruktive ndaj mësimdhënjes dhe nxënjes.
- Të zhvillojnë shkathtësi të nivelit të lartë.
- Të përdorin metoda pedagogjike të bashkëpunimit me nxënësin në qendër.
- Të kenë kujdes në identifikimin dhe zhvillimin e potencialit individual për secilin nxënës.
- Të iu ndihmojë nxënësve të zhvillojnë vetëbesimin, përgjegjësinë dhe shkathtësit shoqërore.
- Të krijojnë dhe mirëmbajnë një mjedis pozitiv dhe të ngroht ku nxënësit do të ndihën të sigurt dhe të rehatëshëm.
- Të forcojnë zhvillimin e zemërgjerësisë dhe tolerancës.
- Të shfytëzojnë udhëzimet e planifikimit për zhvillimin dhe implementimin e kurrikulit.
- Të krijojnë përvojë kuptimplote të të mësuarit për nxënësit.
- Të sigurojnë se nxënësit me nevoja të posaçme kanë të drejtë arsimimi njësojë si të tjerët.
- Të bëjnë përpjekje rreth të mësuarit të përjetëshëm.
- Të kërkojnë kooperim me mësimdhënësit tjerë, me familjën dhe komunitetin e gjerë.

¹ Kapitujt V dhe VI